



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 649, datë 13.8.2020

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR
NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË NJËSIVE
TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKITË SHIJAK
DHE KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 186 772 938 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para në bashkitë Shijak dhe Kurbin.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 90 172 938 (nëntëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale, për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.
- b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 96 600 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I SHITËTIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4142/1
DATË 17.8. 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE SHIJAK DHE KURBIN
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Në mungese dhe me porosi :

Elira KOKONA

